



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER
NDERMARRJA E SHERBIMEVE PUBLIKE FIER**

Nr. ____/____ Prot.

Fier, më 04.04.2025

Lënda: Formulari i njoftimit të fituesit, në përfundim të afateve të ankimit për procedurën me objekt **“Blerje automjete per mirembajtje rrugore”**, me burim financimi nga Buxheti i Ndermarrjes se Sherbimeve Publike Fier.

AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK

TIRANË

(për botim)

Shtojca 12

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT

NDERMARRJA E SHERBIMEVE PUBLIKE FIER

Data: 04.04.2025

Drejtuar: Operatorit ekonomik ARTEO 2018 SH.P.K

NUIS: NUIS L82523203F

Adresa: Elbasan Elbasan Lagjja Luigj Gurakuqi, Bulevardi Aqif Pasha, Hotel Skampa, kati 5 nr.303

* * *

Tipi i Kontratës: Mall

Lloji i Procedurës së prokurimit: Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar-me mjete elektronike.

Numri i Procedurës / Referenca e Lotit: REF-36265-01-29-2025.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Blerje automjete per mirembajtje rrugore”, me fond limit/vlera e pritshme e kontratave prej : **21 979 333** (njëzet e një milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e treqind e tridhjetë e tre) **lekë pa TVSH ose fondi limit në Euro (sipas kursit të këmbimit nga BSH datë 29.01.2025): 220 432.584**

(dyqind e njezete mije e katerqind e tridhjetë e dy pike peseqind e tetedhjetë e kater)
Euro, me burim financimi nga Buxheti i Ndermarrjes se Sherbimeve Publike Fier.=

Kohëzgjatja e kontratës: - 60 ditë nga nënshkrimi i kontratës.

Data e Publikimit në SPE të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit: **25/03/2025**

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve [1 Prill 2025], [Numri 15].

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

- ☐ oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto ☐
- ☐ oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim **PO**

Me anë të këtij Formulari, ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik ANDI HAMO P.F, me NUIS K76926201W. Vlera totale sipas formularit të ofertës është 21 817 900 *(njëzetë e një milion e tetëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e nëntëqind)* lekë pa TVSH. Afati i dorëzimit sipas kërkesës së bërë.
2. Operatori ekonomik ARTEO 2018 SHPK, me NUIS L82523203F. Vlera totale sipas formularit të ofertës është 18 995 000 *(tetëmbëdhjetë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë)* lekë pa TVSH. Afati i dorëzimit sipas kërkesës së bërë.
3. Operatori ekonomik TIRES-R SHPK, me NUIS M12413025K. Vlera totale sipas formularit të ofertës është 21 900 000 *(njëzetë e një milion e nëntëqind mijë)* lekë pa TVSH. Afati i dorëzimit sipas kërkesës së bërë.

Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

- Operatori ekonomik **ANDI HAMO P.F, me NUIS K76926201W** skualifikohet për arsye se:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi shqyrtoi dhe verifikoi dokumentacionin ligjor, ekonomik dhe teknik, të paraqitur në SPE nga operatori ekonomik pjesmarrës **ANDI HAMO P.F me NUIS K76926201W**, konstatoi mangësit si më poshtë:

1. Referuar Shtojcës 8, “**Kriteret e veçanta të kualifikimit**”, “**Kapaciteti teknik**”, në pikën 2.3.2, përcaktohet se:

” Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalog teknik ose fragment të katalogëve ose skedë teknike për mjetet, i cili/e cila minimalisht të përmbajë një përshkrim të karakteristikave teknike dhe të dhenave të tjera të mjetit te cilat duhet të jenë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor. ”

Nga verifikimi i dokumentacionit të ngarkuar në SPE nga operatori ekonomik ANDI HAMO P.F, rezulton se operatori ekonomik ANDI HAMO P.F **nuk ka paraqitur katalog teknik ose**

fragment të katalogëve ose skedë teknike për mjetet, i cili/e cila minimalisht të përmbajë një përshkrim të karakteristikave teknike dhe të dhenave të tjera të mjetit të cilat duhet të jenë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor .

Për sa më sipër, mbështetur në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 , "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, neni 92, pika 3, ku shprehimisht përcaktohet se: "Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit", oferta e operatorit **ANDI HAMO P.F me NUIS K76926201W** s'kualifikohet.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomikë **ARTEO 2018 SH.P.K, me NUIS L82523203F**, me adrese: Elbasan Elbasan Lagjja Luigj Gurakuqi, Bulevardi Aqif Pasha, Hotel Skampa, kati 5 nr.303., se oferta e paraqitur me një vlerë të përgjithshme prej 18 995 000 (*tetëmbëdhjetë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë*) lekë pa TVSH dhe prej 22 794 000 (*njëzetë e dy million e shtatëqind e nëntëdhjetë e katër mijë*) lekë me TVSH, është identifikuar si oferta fituese.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Autoriteti Kontraktor Ndërmarrja e Sherbimeve Publike Fier, Lagja "11 Janari", Rruga "Ramiz Aranitasi" Fier, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Nëse nuk dorëzoni sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar të parashikuar në dokumentet e tenderit, apo tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do t'ju konfiskohet siguri i ofertës suaj dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej 21 900 000 (*njëzetë e një milion e nëntëqind mijë*) lekë pa TVSH, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", të ndryshuar.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit, nga i cili nisin afatet e ankimit /Njoftimit të Anulimit, nga i cili nisin afatet e ankimit

PO ☐ JO ☒

Nëse Po (Nr.____ Datë____ i vendimit përfundimtar për shqyrtimin e ankesës, të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik)

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Arjan NDREU